

02.11.



C.nr.430/10

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti i Pergjithshem-Divizioni Civil, gjyqtari Enes Mehmeti me procesmbajtësen Minire Krasniqi, ne ceshtjen juridike te inicuar me padine e paditesit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna e Ferizajt, të cilin e përfaqëson me autorizim av. [REDACTED] nga Ferizaj kunder te paditures Korporata Elektroenergjetike e Kosoves [distrikti Ferizaj, te cilin me autorizim e perfaqeson [REDACTED] per shperblim demi material, ne seancen e mbajtur me date 1.2.10.2015, ne pranine e paleve ndergjygjese, me date 15.10.2015 merr dhe publikon kete:

AKTGJYKIM

APROVOHET, në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna e Ferizajt dhe **DETYROHET** e paditura KEK Distrikti ne Ferizaj, që në emër të kompensimit të dëmit, për shkak të mbytjes së lopës nga kabloja elektrike, t'ia paguan paditësit shumën prej 1,300.00€ (njëmijëetreqindëruo), si dhe shpenzimet e procedures në shumë prej 164.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me forcë.

OBLIGOHET paditesi qe te paguan taksen gjyqesore per padi dhe aktgjykim ne shume prej 30.00 euro, pas pranimit te ketij Aktgjykimi, nen kercenimin e pasojave juridike.

Arsyetimi

Paditesi, përmes të autorizuarit te tij, në padi dhe parashtrimet ne seancen e mbajtur, ka pretenduar se per shkak te shkeputjes se kablos elektrike nga rrjeti I te paditures, ka pesaur lopa e tij e cila ka ngordhur si pasoje e vperimit te energjise elektrike ne trupin e saj. Ka shtuar se ky fakt eshte vertetuar edhe nga komisioni I te paditures dhe kjo eshte konstatuar edhe nga veterinary I licencuar I cili ka konstatuar shkakun e ngordhjes se lopes dhe karakteristikat e saj gjegjeisht vleresimin per peshen dhe cimimin real te tregut.

Kane pretenduar se pergjegjes per ngordhjen e lopes se paditesit eshte e apditura sepse kjo ka ndodhur per shkak te veprimit te stabilimenteve qe jane nen menaxhimin dhe veprimtarine e te paditures.

I kane kerkuar shpenzimet e procedures.

E paditura, ne pergjigje ne padi dhe parashtrimet ne séance ka kontestuar kerkesepadine e paditesit sit e pa bazuar, per shkak se paditesi nuk eshte kujdesur per lopen dhe se tensioni I rrymes ka qene I vogel qe nuk mund te shkakton ngordhjen e lopes, pork jo ka mudnt e ndodh per shkak te "tensionit e hapit", e cila ka bere qe rryma te kalon ne organet e brendshme te lopes dhe te shkakton ngordhjen.

Kane kontestuar raportin e veterinarit me arsyetim se nje raport I tille nuk eshte nxjerrur nga gjykata dhe se nuk duhet te mirret parasysht cmimi I tregut qe eshte caktuar nga veterinari.

Gjykata me qellim te vertetimit te drejte te gjendjes se fakteve te kesja ceshtjeje ka administruar provat si vijone: raportin e veterinarit date 10.11.2010, raportin e komisionit te te paditures nr.1026 date 19.11.2010 si dhe fotot e vendit te ngjarjes.



Gjykata pas shqyrtimit dhe analizimit te provave te ceshtjes, ne kuptim te nenit 8 te LPK-se, ka gjetur se duhej vendosur si ne dispozitiv, vleresim ky i nxjer ne baze te bindjes se lire te gjykates e krijuar nga gjendja e fakteve dhe vleresimi lisecales prove te ceshtjes dhe te nderlidhura si teresi mes veti.

Gjykata ne kete ceshtje kontestuese, ka vertetuar faktin se per shkak te veprimit te kabllos se rrjetit elektrik te te paditures, me date 10.11.2010 dhe si pasoje e kontaktit te kabllit me lopen ka ardhur deri te ngordhja e lopes se paditesit. Ky fakt eshte vertetuar nga raporti I te paditures date 19.11.2010 numer 1026, dhe kjo eshte konstatuar edhe nga vleresimi profesional i dhene nga veterinarit [REDACTED] me date 10.11.2010, prandaj nisur nga kjo gjetje gjykata vlerson se e paditura ka pergjegjesine per te kompensuar paditesin per demin qe ka pesuar, per shkak te humbjes se lopes, te cilin kompensim e paditura ka per detyre t'ia bene ne baze te pergjegjesise se saj objective, per demet qe pesojne te tretet nga pasojat qe sjellin stabilimentete elektrike gjate funksionimit te tyre ne funksion te realizimi te fushveprimtarise se te paditures si furnizuese me energji elektrike.

Gjithashtu gjykata ne kete ceshtje juridike ka gjetur se e paditura ka per detyre qe paditesit t'ia kompenzon shumen prej 1,300.00€, per shkak te humbjes se lopes se tij, si dem material dhe se cmimi ne fjale eshte cmimi I tregut te lopes sic ka percaktuar edhe raporti I veterinarit e te cilit kjo gjykate ia ka falur besimin si profesionale dhe te drejte duke qene se veterinary eshte I thirrur per te dhene vleresimin lidhur me shendetin dhe vleresime per vleren e kafsheve konkretisht lopes se paditesit.

Gjykata bazuar ne nenin 154 par.2 lidhur me nenin 185 parg. 4 te LMD-se, GZ e RSFJ numer 29 date 26.5.1978, ligj I aplikueshem per kete rast, ka gjykuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata pretendimet e perfaqesuesit te te paditures per faktin se nuk ka pergjegjesi per humbjen e lopes se paditesit dhe se cmimi I caktuar nga veterinary nuk eshte cmim I tregut, gjykata I vleresoi si ne kundershtrim me provat e e prezantuara nga paditesi dhe sit e tilla keto deklarime paraqesim kundershtrime thjesht declarative, te pambeshtetura ne prova.

Gjykata ka obliguar te paditoren qe t'ia kompenzon shpenzimet e procedures paditesit ne shume prej 164.00€, dhe ate per nje perfaqesim nga avokati dhe per taksat gjyqesore, bazuar ne nenin 452.1 lidhur me nenin 453 te LPK-se, ndersa paditesin per pagesen e taksave gjyqesore ne baze te Ua nr.2008/2 te KGJK-se.

Nga parashtrimet si me siper eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.430/10 date 16.10.2015

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ESHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Ac.nr. 775/17

Më Dana 17.12 2018



Gjyqtari,
Enes MEHMETI

Shënime Juridike: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh, te shprehur ne gjykatën e Apelit ne Prishtines, pemes kesaj gjykate. Afati fillon nga dita e shprehur pas pranimit te aktgjykimit.

